

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për Diasporën”, i ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Kombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Kombëtare për Diasporën 2021-2025 dhe Plani i Veprimit
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	4 – 29 mars 2024
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Shkurt 2024
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2024-MEPJ-Nr.1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Ejona Hoxha, Drejtoria e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve ejona.hoxha@mfa.gov.al Enkeleda Riza, Drejtoria e Diplomacisë Publike dhe Diasporës enkeleda.riza@mfa.gov.al Natalia Kapllanaj, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar natalia.kapllanaj@mfa.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Në zbatim të programit të ri të qeverisë 2021-2025, u vendos edhe riorganizimi i disa prej institucioneve. Me qëllim arritjen e objektivave të vendosura dhe forcimin e politikës së jashtme, Këshilli i Ministrave ndryshoi fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme me vendimin nr.81, datë 9.2.2022, sipas të cilit MEPJ-ja caktohet si institucion përgjegjës për diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i perkiste Ministrisë të Shtetit për Diasporën.

Si rezultat i këtij ndryshimi, MEPJ-së i lindi detyrimi për të bërë një vlerësim të legjislacionit në fuqi në përputhje me politikat dhe objektivat e qeverisë dhe të MEPJ-së, në zbatim të politikës së jashtme.

Së pari, MEPJ vlerësoi nevojën dhe shfuqizoi ligjin nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, duke vendosur që niveli i autoritetit shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën të rritet nga niveli i një agjencie kombëtare në nivel Ministrie për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjithashtu, bazuar në VKM-në nr.82, datë 9.2.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, Qendra e Botimeve të Diasportës, kaloi në varësi administrative të ministrit përgjegjës për arsimin.

Për rrjedhojë, këto ndryshime janë vlerësuar të domosdoshme të reflektohen edhe në ligjin

nr.16/2018, “Për diasporën”, i ndryshuar, ndryshime të cilat konsistojnë në formë dhe përmbajtje, kryesisht sa i takon organizimit të veprimtarisë së strukturave, funksionit dhe përgjegjësisë që do të kenë, në mënyrë që të shmangen mospërputhjet e kuadrit rregullator dhe pa kuptueshmëria e dispozitave të ligjit në raport me ndryshimet e lartpërmendura.

Nëse nuk do të kemi harmonizim të këtij ligji me pasojat që sjell ndryshimi i fushës së përgjegjësisë për AKD por edhe me ligjin për Shërbimin e Jashtëm të RSH-së, do të jemi në kushtet e një konfuzioni ligjor dhe mospërputhje të akteve ligjore, duke e bërë të pamundur zbatimin efektiv të këtij ligji.

Së dyti, kuadri ligjor duke qenë i pa harmonizuar nuk është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e qeverisë, reflektuar edhe në programin e qeverisë 2021-2025, ku një prej qëllimeve kryesore dhe projekteve afatgjatë të shtetit shqiptar është krijimi i një hapësire të përbashkët mbarëshqiptare, në zemër të familjes së kombeve europiane, në respekt të plotë me të drejtat e vendeve fqinje dhe në përputhje të plotë me sovranitetin e tyre apo parimet e shëndosha ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, kuadri ligjor i pa harmonizuar bëhet pengesë për arritjen në kohë të objektivave të vendosura nga qeveria, të cilat për më tepër kanë një afat të përcaktuar realizimi.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Forcimi i mëtejshëm i politikave shtetërore për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, duke rritur nivelin e autoritetit shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën nga niveli i një Ministër shteti, në nivel Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përmbushja e objektivave në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 dhe realizimi i masave të planit të saj të veprimit.
- Riorganizimi i bashkëpunimit me diasporën me qëllim ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe trashëgimisë kulturore të diasporës.
- Rritja e bashkëpunimit ekonomik, shkencor, teknologjik, kulturor, arsimor dhe sportiv ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Me qëllim arritjen e objektivit të sipërcituar janë shqyrtuar tre opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0: Ky opsion nuk i zgjidh problematikat e sipërcituara. Kostot dhe përfitimet për aktorët e përfshirë do të jenë të pandryshueshme dhe problemet e identifikuar nuk do të adresohen saktësisht aty ku duhet dhe si rrjedhim do të zvarritet zgjidhja e tyre, duke krijuar konfuzion ligjor, i cili do të sjellë mungesë të efektivitetit dhe cilësisë së këtij ligji.

Opsioni 1 (rregullator): Ndryshimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar. Ky opsion synon të shmangë mospërputhjen e kuadrit rregullator për diasporën, si pasojë e ndryshimeve të menjëhershme që sjell shfuqizimi i ligjit nr.115/2017, datë 18.12.2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Nëpërmjet këtij opsioni do të mund të

sigurohet harmonizimi dhe përmirësimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, duke marrë parasysh ndryshimin e fushës së përgjegjësië për çështjet e diasporës si dhe përshtatjen e tij me ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”. Në këtë mënyrë, shmanget edhe mospërputhja e kuadrit rregullator si dhe garantohet zbatimi i politikave shtetërore për ndjekjen e çështjeve lidhur me diasporën dhe organizimin e strukturave përgjegjëse. Gjithashtu, edhe në këndvështrimin e zbatimit të rregullave të teknikës legjislative, ky opsion rezulton të jetë më i favorshmi për të zbatuar politikën.

Opsioni 2 (rregullator): Shfuqizimi i ligjit nr. 16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar dhe hartimi dhe miratimi i një ligji të ri. Miratimi i një ligji të ri, në vlerësimin tonë nuk duket të jetë opsioni më i mirë, i cili jo vetëm do të cënonte parimin e sigurisë juridike, por do të kërkonte kohë dhe angazhimin e shumë burimeve financiare. Gjithashtu, në kuadër të teknikës legjislative, ndryshimet e parashikuara nuk prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit. Për këtë arsye, ndërmarrja e një nisme për hartimin e një ligji të tillë nuk është e nevojshme.

Opsioni 3 (jo rregullator): Mundësia e interpretimeve, bazuar në kuadrin ligjor mbi fushën e përgjegjësisë së MEPJ-së por edhe të MAS-it për strukturat kompetente të këtyre të fundit, të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për çështjet e diasporës. Mungesa e harmonizimit dhe mbështetja vetëm tek elementi interpretativ, ndërlikon ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiave mes strukturave të MEPJ-së, por edhe të MAS-it, duke sjellë mungesë të efektivitetit, vështirësi në të kuptuarit të ligjit nga strukturat zbatuese.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Grupet e prekura ose përfituese nga miratimi i opsionit të parë janë:

- 1) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturat përkatëse, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra për Studime dhe Publikime për Arbëreshët, Qendrat Kulturore të Diasporës si dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit me Qendrën e Botimeve për Diasporën.
- 2) Të gjithë pjesëtarët e diasporës dhe qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë (diasporë).

Ndikimet e drejtpërdrejta për grupin e parë të prekur nga ndryshimi i politikës:

- Arritja me efikasitet dhe efektivitet i objektivave të përcaktuara në politikat e angazhimit të diasporës dhe mbikëqyrja e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, pasi do të përdoret vetëm një kanal komunikimi, në vend të atij me shumë drejtime që kemi pasur deri më tani;
- Rritja e efikasitetit dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit në drejtim të diasporës;
- Rritja e nivelit të përmbajtjes së teksteve të botuara për diasporën, rritja e numrit dhe e nivelit të programeve për mësimin e gjuhës shqipe dhe e numrit të personave që mësojnë gjuhë dhe kulturë shqiptare, pasi tashmë do të jenë: Ministri përgjegjës për diasporën dhe MAS, përgjegjës për zbatimin e programeve për mësimin e gjuhës shqipe nga distanca, organizimin e seminareve trajnuese dhe promovimin e mësimave plotësues për pjesëtarët e diasporës;

- Qendrat Kulturore të Diasporës tashmë do të kenë detyra dhe përgjegjësi të mirë përcaktuara dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve të tyre do të ketë ndikim në ruajtjen e kulturës dhe identitetit kombëtar në diasporë.

Ndikimet e drejtpërdrejta për pjesëtarët e diasporës dhe qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë (diasporë):

- Do të rriten mundësitë për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, duke bërë të mundur ruajtjen e identitetit kombëtar;
- Sigurimi i botimeve dhe programeve më efikase që do të përgatiten dhe zbatohen për diasporën;
- Mbrojtje më e mirë e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës;
- Përfshirje më e madhe e pjesëtarëve të diasporës në jetën kulturore të Shqipërisë nëpërmjet riorganizimit të Qendrave Kulturore të Diasporës.
- Ndikim shumë i rëndësishëm për qytetarët dhe për shtetin do të jetë mirë-funksionimi i institucioneve shtetërore, duke qene se do të ketë një mirëpërcaktim të fushës së përgjegjësisë së këtyre institucioneve, si dhe kompetencat e secilit prej këtyre institucioneve do të pasqyrohen qartë dhe nuk do të ketë mundësi mbivendosje të tyre. Në këtë mënyrë do të shmangim mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet institucioneve.

Sa i përket analizës sasiore mbi ndikimet financiare direkte/indirekte të ndryshimit të politikës mund të themi se kjo politikë nuk sjell efekte negative monetare për Buxhetin e Shtetit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 1 (rregullator), ndryshimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, ofron krijimin e kushteve optimale për arritjen me efikasitet dhe efektivitet të objektivave të përcaktuara në politikat e angazhimit të diasporës, duke shmangur strukturat e mbivendosura, qartëson kompetencat e secilit prej strukturave, duke shmangur në këtë mënyrë mosmarrëveshjet e kompetencave dhe paqartësitë në interpretimin e ligjit.

Kalimi i çështjeve për diasporën nën përgjegjësinë e MEPJ, kërkon ndër të tjera edhe disa ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, me qëllim reflektimin ku është e mundur të fushës së përgjegjësisë, si dhe përmirësimin e disa dispozitave të cilat krijojnë konfuzion dhe e bëjnë të vështirë zbatimin efektiv të tij.

Këto ndryshime synojnë përmirësimin e ligjit për diasporën, rritjen e ndërveprimit me komunitetin shqiptar jashtë Shqipërisë, përcaktimin e procedurave dhe mekanizmave për rritjen e bashkëpunimit me diasporën, me qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar.

Opsioni 1 është i vetmi, që mund të përmbushë nevojën për harmonizimin dhe përmirësimin e ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, duke marrë parasysh ndryshimin e fushës së përgjegjësisë për çështjet e diasporës si dhe përshtatjen e tij me ligjin nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, pasi ky opsion nuk sjell efekte negative (kosto) monetare për Buxhetin e Shtetit.

Nëpërmjet këtij opsioni synohet forcimi i meteishëm i politikave shtetërore për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit me diasporën.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

	FINANCA	

Siç është përmendur dhe me sipër, opsionet e shtruara në këtë raport janë në thelb mënyra të ndryshme ligjore sesi mendohet ti jepet zgjidhje problematikave të ardhura si pasojë e ndryshimit të kuadrit ligjor dhe fushës së përgjegjësisë së institucioneve në fjalë.

Shkurtimisht zgjidhja ndërmjet opsioneve të dhëna ka të bëjë me faktin nëse ndryshimet e nevojshme ligjore do të marrin formën e një ligji të ri, do të jenë pjesë e ligjit ekzistues apo nuk do bëhen ndryshime ligjore por do ndiqet rruga e interpretimit. Në analizën ekonomike është e rëndësishme të kuptohet që pavarësisht zgjidhjes së bërë ndërmjet këtyre opsioneve, puna do të realizohet nga të njëjtat struktura. Përpunimi dhe plotësimi i legjislacionit ekzistues (opsioni 1), apo hartimi i një projektligji të posaçëm (opsioni 2) apo interpretimi nga organet përkatëse (opsioni 3), realizohet me stafin ekzistues, pjesë të institucioneve.

Pra, në asnjë nga opsionet e marra në shqyrtim nuk do kemi kosto shtesë. Rrjedhimisht duke mos patur kosto shtesë në krahasim me opsionin 0 të status quo-së, përlllogaritja e VAN nuk ka vlerë për qëllimin e këtij dokumenti dhe përzgjedhjen e opsionit më të mirë kosto-efektiv.

Në lidhje me impaktin social, duhet përmendur që duke patur një procedurë të mirë-përcaktuar, me aktorë dhe role të qarta, mundësohet transparenca për gjithë subjektet e prekura dhe të interesuara si dhe siguria në kuadër të të drejtës së ankimit nga ana e subjekteve të prekura. Nga ana tjetër, për vetë natyrën e kësaj politike, nuk kemi impakt mjedisor në asnjë nga opsionet e shqyrtuara.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, ky projektligj publikohet në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, për një periudhë 20 ditë pune nga dita e publikimit në RENJKP.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme së bashku me strukturat e posaçme në MEPJ, AKD dhe QSPA, si dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit me Qendrën e Botimeve të Diasporës janë strukturat përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

Monitorimi i zbatimit të politikës do të kryhet nga MEPJ dhe MAS sa i takon Qendrës së Botimeve të Diasporës, nëpërmjet raporteve periodike informuese mbi statusin e objektivave të përcaktuara.

- Niveli i harmonizimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor;
- Efikasiteti i strukturave përgjegjëse për diasporën (jo vetëm strukturës së posaçme por edhe të misionëve diplomatike dhe posteve konsullore) në përmbushjen e detyrave bazuar në numrin e aplikimeve/ankesave/kërkesave të trajtuara; eventeve sensibilizuese të organizuara etj;
- Numri i botimeve të kryera nga QBD, në ndihmë të diasporës;
- Numri i personave (anëtarë të diasporës) që kanë ndjekur programet për mësimin e gjuhës shqipe në distancë;
- Numri i seminareve trajnuese për mësim plotësues dhe numri i anëtarëve të diasporës, pjesëmarrës në këto seminare trajnuese, etj.

Pengesa në zbatimin e politikës nuk parashikohet të ketë, sepse ligji synohet të ketë vetëm ndryshim teknik.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji nr.16/2018 “Për diasporën“, i ndryshuar, është miratuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në datën 18.12.2017, me iniciativë të Ministrit të Shtetit për Diasporën. Ligji ka pasur si qëllim përcaktimin e rregullave për:

- a) kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën;
- b) mënyrën e mbajtjes, të forcimit dhe realizimit të lidhjeve të diasporës me vendin e origjinës;
- c) krijimin e Këshillit Koordinues të Diasporës;
- ç) dhënien e çmimeve kombëtare në fushën e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- d) ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet shtetërore në vendin e origjinës.

Në zbatim të programit të ri të qeverisë 2021-2025 u vendos edhe riorganizimi i disa prej institucioneve. Me qëllim arritjen e objektivave të vendosura dhe forcimin e politikës së jashtme, Këshilli i Ministrave ndryshoi fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme me vendimin nr.81, datë 9.2.2022, sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i përkiste Ministrit të Shtetit për Diasporën.

Në MEPJ ka ekzistuar gjithmonë një departament i veçantë i quajtur, “Instituti i Diasporës” i cili kishte përgjegjësinë dhe angazhimet për marrëdhëniet e shtetit shqiptar me pjesën e popullsisë shqiptare që jetonte e punonte jashtë, duke filluar që nga mbarëvajtja e mësimin shqip në diasporë, aktivitetet e ndryshme kulturore, zgjedhjen e problematikave të tyre etj. Me krijimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Agjencisë Kombëtare për Diasporën, ky departament për diasporën në MEPJ u shkri.

Gjithashtu, bazuar në VKM nr. 82, datë 9.2.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, Qendra e Botimeve të Diasporës, ka kaluar në varësi administrative të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Problemi në shqyrtim

- Përshkruani natyrën e problemit.
- Identifikoni shkaqet e problemit.
- Përshkruani shtrirjen e problemit.
- Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët. MEPJ?
- Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Gjatë vitit 2022, në zbatim të programit të ri të qeverisë 2021-2025 u vendos edhe riorganizimi i disa prej institucioneve. Me qëllim arritjen e objektivave të vendosura dhe forcimin e politikës së jashtme, Këshilli i Ministrave ndryshoi fushën e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme me vendimin nr.81, datë 9.2.2022, sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i përkiste Ministrit të Shtetit për Diasporën.

Si rezultat i këtij ndryshimi, MEPJ-së i lindi detyrimi për të bërë një vlerësim të legjislacionit në fuqi në përputhje me politikat dhe objektivat e qeverisë, dhe objektivave të MEPJ-së, në zbatim të politikës së jashtme.

Së pari, MEPJ vlerësoi dhe shfuqizoi ligjin nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, duke vendosur që niveli i autoritetit shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën të rritet nga niveli i një agjencie kombëtare në nivel Ministrie për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Gjithashtu, bazuar në VKM nr.82, datë 9.2.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, Qendra e Botimeve të Diasportës, ka kaluar në varësi administrative të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Për rrjedhojë këto ndryshime janë vlerësuar të domosdoshme të reflektohen edhe në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, ndryshime të cilat konsistojnë në formë dhe përmbajtje, kryesisht sa i takon organizimit të veprimtarisë së strukturave, funksionit dhe përgjegjësisë që do të kenë, në mënyrë që të shmangen mospërputhjet e kuadrit rregullator, pa kuptueshmëria e dispozitave të ligjit në raport me ndryshimet e lartpërmendura.

Nëse nuk do të kemi harmonizim të këtij ligji me pasojat që sjell ndryshimi i fushës së përgjegjësisë për AKD, por edhe me ligjin për Shërbimin e Jashtëm të RSH-së, do të jemi në kushtet e një konfuzioni ligjor dhe mospërputhje të akteve ligjore, duke e bërë të pamundur zbatimin efektiv të këtij ligji.

Së dyti, kuadri ligjor duke qenë i pa harmonizuar nuk është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e qeverisë, reflektuar edhe në programin e qeverisë 2021-2025, ku një prej qëllimeve kryesore dhe projekteve afatgjatë të shtetit shqiptar është krijimi i një hapësire të përbashkët mbarëshqiptare, në zemër të familjes së kombeve europiane, në respekt të plotë me të drejtat e vendeve fqinje dhe në përputhje të plotë me sovranitetin e tyre apo parimet e shëndosha ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, kuadri ligjor i pa harmonizuar bëhet pengesë për arritjen në kohë të objektivave të vendosura nga qeveria, të cilat për më tepër kanë një afat të përcaktuar realizimi.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Qeveria*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Përmirësimi i ligjit aktual për diasporën dhe shfuqizimi i ligjit për Agjencinë Kombëtare për Diasporën, ka sjell nevojën për ndërthurjen e këtij ligji për diasporën me ligjin për Shërbimin e Jashtëm.

MEPJ bën hartimin e politikave shtetërore për diasporën, ndërmer hapa të rëndësishëm dhe konkretë për ruajtjen e lidhjeve të diasporës me vendin e origjinës, tërheqjen dhe rritjen e kontributeve të diasporës në atdhe, jo vetëm në aspektin ekonomik por edhe të burimeve dhe resurseve njerëzore, duke u bazuar edhe në planet e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën për vitet 2021-2025.

Me vendimin nr.81, datë 9.2.2022, MEPJ-ja caktohet si institucion përgjegjës për diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i përkiste Ministrisë së Shtetit për Diasporën.

Si rezultat i këtij ndryshimi, MEPJ-së i lindi detyrimi për të bërë një vlerësim të legjislacionit në fuqi në përputhje me politikat dhe objektivat e qeverisë dhe të MEPJ-së, në zbatim të politikës së jashtme, me qëllim që të shmangë mospërputhjen e kuadrit rregullator për diasporën, si pasojë e ndryshimeve të menjëhershme që sjell shfuqizimi i ligjit nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Arsyeja kryesore është që të sigurohet harmonizimi dhe përmirësimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, duke marrë parasysh ndryshimin e fushës së përgjegjësisë për çështjet e diasporës si dhe përshtatjen e tij me ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

Në këtë mënyrë shmanget edhe mospërputhja e kuadrit rregullator si dhe garantohet zbatimi i politikave shtetërore për ndjekjen e çështjeve lidhur me diasporën dhe organizimin e strukturave përgjegjëse. Gjithashtu, edhe në këndvështrimin e zbatimit të rregullave të teknikës legjislative, ky opsion rezulton të jetë më i favorshmi për të zbatuar politikën.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, realë dhe në kohë.*
- Forcimi i mëtijshëm i politikave shtetërore për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, duke rritur nivelin e autoritetit shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën nga niveli i një ministri shteti, në nivel Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe nga niveli i një agjencie kombëtare në nivel Ministrie për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përmbyllja e objektivave në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 dhe realizimi i masave të planit të saj të veprimit.
- Riorganizimi i bashkëpunimit me diasporën me qëllim ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe trashëgimisë kulturore të diasporës.

- Rritja e bashkëpunimit ekonomik, shkencor, teknologjik, kulturor, arsimor dhe sportiv ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Me qëllim arritjen e objektivit të sipërcituar janë shqyrtuar tre opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0: Ky opsion nuk i zgjidh problematikat e sipërcituara. Kostot dhe përfitimet për aktorët e përfshirë do të jenë të pandryshueshme dhe problemet e identifikuar nuk do të adresohen saktësisht aty ku duhet dhe si rrjedhim do të zvarritet zgjidhja e tyre, duke krijuar konfuzion ligjor, i cili do të sjellë mungesë të efektivitetit dhe efikasitetit të këtij ligji.

Opsioni 1 (rregullator): Ndryshimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar. Ky opsion synon të shmangë mospërputhjen e kuadrit rregullator për diasporën, si pasojë e ndryshimeve të menjëhershme që sjell shfuqizimi i ligjit nr.115/2017, datë 18.12.2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”. Nëpërmjet këtij opsioni do të mund të sigurohet harmonizimi dhe përmirësimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, duke marrë parasysh ndryshimin e fushës së përgjegjësisë për çështjet e diasporës si dhe përshtatjen e tij me ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”. Në këtë mënyrë shmanget edhe mospërputhja e kuadrit rregullator si dhe garantohej zbatimi i politikave shtetërore për ndjekjen e çështjeve lidhur me diasporën dhe organizimin e strukturave përgjegjëse. Gjithashtu, edhe në këndvështrimin e zbatimit të rregullave të teknikës legislative, ky opsion rezulton të jetë më i favorshmi për të zbatuar politikën.

Opsioni 2 (rregullator): Shfuqizimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar dhe hartimi dhe miratimi i një ligji të ri. Miratimi i një ligji të ri, në vlerësimin tonë nuk duket të jetë opsioni më i mirë, i cili jo vetëm do të çenonte parimin e sigurisë juridike por do të kërkonte kohë dhe angazhimin e shumë burimeve financiare. Gjithashtu në kuadër të teknikës legislative, ndryshimet e parashikuara nuk prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së ligjit. Për këtë arsye, ndërmarrja e një nisme për hartimin e një ligji të tillë nuk është e nevojshme.

Opsioni 3 (jo rregullator): Mundësia e interpretimeve, bazuar në kuadrin ligjor mbi fushën e përgjegjësisë së MEPJ-së por edhe të MAS-it për strukturat kompetente të këtyre të fundit, të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për çështjet e diasporës. Mungesa e harmonizimit dhe mbështetja vetëm tek elementi interpretativ, ndërlikon ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi mes strukturave të MEPJ-së por edhe MAS duke sjellë mungesë të efektivitetit, vështirësi në të kuptuarit të ligjit nga strukturat zbatuese.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*

- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opcion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Grupet e prekura ose përfituese nga miratimi i opsionit të parë janë:

- 1) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturat përkatëse, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra për Studime dhe Publikime për Arbëreshët, Qendrat Kulturore të Diasporës si dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit me Qendrën e Botimeve për Diasporën.
- 2) Të gjithë pjesëtarët e diasporës dhe qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë (diasporë).

Ndikimet e drejtpërdrejta për grupin e parë të prekur nga ndryshimi i politikës:

- Arritja me efikasitet dhe efektivitet i objektivave të përcaktuara në politikën e angazhimit të diasporës dhe mbikqyrjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, pasi do të përdoret vetëm një kanal komunikimi, në vend të atij me shumë drejtime që kemi pasur deri më tani;
- Rritja e efikasitetit dhe përmirësimi i cilësisë së ofrimit të në drejtim të diasporës;
- Rritja e nivelit të përmbajtjes së teksteve të botuara për diasporën, rritja e numrit dhe e nivelit të programeve për mësimin e gjuhës shqipe dhe e numrit të personave që mësojnë gjuhë dhe kulturë shqiptare, pasi tashmë do të jenë; Ministri përgjegjës për diasporën dhe MAS, përgjegjës për zbatimin e programeve për mësimin e gjuhës shqipe nga distanca, organizimin e seminareve trajnuese dhe promovimin e mësimave plotësues për pjesëtarët e diasporës;

- Qendrat Kulturore të Diasporës tashmë do të kenë detyra dhe përgjegjësi të mirë-përcaktuara dhe mënyra e ushtrimit të funksioneve të tyre do të ketë ndikim në ruajtjen e kulturës dhe identitetit kombëtar në diasporë.

Ndikimet e drejtpërdrejta për pjesëtarët e diasporës dhe qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë (diasporë):

- Do të rriten mundësitë për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, duke bërë të mundur ruajtjen e identitetit kombëtar.
- Sigurimi i botimeve dhe programeve më efikase që do të përgatiten dhe zbatohen për diasporën.
- Mbrojtje më e mirë e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës.
- Përfshirje më e madhe e pjesëtarëve të diasporës në jetën kulturore të Shqipërisë nëpërmjet riorganizimit të Qendrave Kulturore të Diasporës.
- Ndikim shumë i rëndësishëm për qytetarët dhe për shtetin do të jetë mirëfunksionimi i institucioneve shtetërore, duke qenë se do të ketë një mirë-përcaktim të fushës së përgjegjësisë së këtyre institucioneve, si dhe kompetencat e secilit prej këtyre institucioneve do të pasqyrohen qartë dhe nuk do të ketë mundësi mbivendosje të tyre. Në këtë mënyrë do të shmangim mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet institucioneve.
- Sa i përket analizës sasiore mbi ndikimet financiare direkte /indirekte të ndryshimit të politikës mund të themi se kjo politikë nuk sjell efekte negative monetare për subjektet e lartpërmendura dhe për Buxhetin e Shtetit, pasi politika e propozuar dhe ndryshimet respektive kanë karakter teknik dhe nuk sjellin implikime në vlerë monetare.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 1 (rregullator), ndryshimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, ofron krijimin e kushteve optimale për arritjen me efikasitet dhe efektivitet të objektivave të përcaktuara në politikën e angazhimit të diasporës, duke eliminuar strukturat e mbivendosura, do të qartësojë kompetencat e secilit prej strukturave, duke shmangur në këtë mënyrë mosmarrëveshjet e kompetencave dhe paqartësitë në interpretimin e ligjit.

Kalimi i çështjeve për diasporën nën përgjegjësinë e MEPJ-së, kërkon ndër të tjera edhe disa ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, me qëllim reflektimin ku është e mundur të fushës së përgjegjësisë, si dhe përmirësimin e disa dispozitave të cilat krijojnë konfuzion dhe e bëjnë të vështirë zbatimin efektiv të tij.

Këto ndryshime synojnë përmirësimin e ligjit për diasporën, rritjen e ndërveprimit me komunitetin shqiptar jashtë Shqipërisë, përcaktimin e procedurave dhe mekanizmave për rritjen e bashkëpunimit me diasporën, me qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar.

Opsioni 1 është i vetmi, që mund të përmbushë nevojën për harmonizimin dhe përmirësimin e ligjit nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar, duke marrë parasysh ndryshimin e fushës së

përgjegjësisë për çështjet e diasporës si dhe përshtatjen e tij me ligjin nr.23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, pasi ky opsion nuk sjell efekte negative (kosto) monetare për Buxhetin e Shtetit.

Nëpërmjet këtij opsioni synohet forcimi i metejshëm i politikave shtetërore për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit me diasporën.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me strukturën e posaçme, AKD dhe QSPA si dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit me Qendrën e Botimeve për Diasporën janë strukturat përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

Masat që do të ndërmerren për zbatimin e këtij opsioni janë:

- MEPJ do të zhvillojë dhe koordinojë bashkëpunimin me institucionet dhe me misionet diplomatike/postet konsullore/misionet shqiptare jashtë vendit për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me diasporën;
- Struktura dhe organika e Qendrave Kulturore të Diasporës miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme;
- Ministri përgjegjës për Diasporën dhe MAS do të përgatisin dhe zbatojnë programe për mësimin e gjuhës shqipe në distancë;
- Ministri përgjegjës për Diasporën dhe MAS do të organizojnë seminare trajnuese për mësuesit dhe do të marrin masa për promovimin dhe inkurajimin e mësimin plotësues për pjesëtarët e diasporës.
- Pengesa në zbatimin e politikës nuk parashikohet të ketë, sepse ligji synohet të ketë vetëm ndryshim teknik.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i zbatimit të politikës do të kryhet nga MEPJ dhe MAS, sa i takon Qendrës së Botimeve të Diasporës, nëpërmjet raporteve periodike informuese mbi statusin e objektivave të përcaktuara.

- Niveli i harmonizimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor;
- Efikasiteti i strukturave përgjegjëse për diasporën (jo vetëm strukturës së posaçme por edhe të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore) në përmbushjen e detyrave bazuar në numrin e aplikimeve/ankesave/kërkesave të trajtuara; eventeve sensibilizuese të organizuara etj;
- Numri i botimeve të kryera nga QBD, në ndihmë të diasporës;
- Numri i personave (anëtarë të diasporës) që kanë ndjekur programet për mësimin e gjuhës shqipe në distancë.
- Numri i seminareve trajnuese për mësim plotësues dhe numri i anëtarëve të diasporës, pjesëmarrës në këto seminare trajnuese, etj.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			